



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BELSH

ADRESA: BELSH, ELBASAN

BASHKIABELSH@HOTMAIL.COM

Nr. _____ Prot.

Belsh me 15/12/2016

KONTRATË SHËRBIM - PROJEKTIMI

OBJEKTI

“Hartim Projektesh “

Belsh 2016



KONTRATË SHËRBIM- PROJEKTIMI

“Hartim projektesh

- ✘ SISTEMIM ASFALTIM RRUGA TROJAS (UNAZA E QYTETIT BELSH) ME VLERE 2,892,000 LEKE PA TVSH ✓ *KUZ Gaud,sh +*
- ✘ SISTEMIM ASFALTIM I RRUGES GREKAN – SHELGU -GJYRALE ME VLERE 5,535,000 LEKE PA TVSH ✓
- ✘ HARTIMI I PROJEKTIT RIKONSTRUKSION SHKOLLE E MESME (QENDER KOMUNITARE) ME VLERE 3,942,000 LEKE PA TVSH ✓
- RIKONSTRUKSION I RRUGES QENDER BELSH_ QAFE SHKALLE ME ME VLERE 1,491,000 LEKE PA TVSH ✓
- HARTIMI I PROJEKTI KUZ LAGJE QAFE SHKALLE ME VLERE 2,841,000 LEKE PA TVSH
- ✘ HARTIMI I PROJEKTIT TE RRUGEVE TE BRENDSHME TE LAGJES QAFE SHKALLE ME VLERE 2,151,000 LEKE PA TVSH ✓

Lidhur sot më datë _____ 2016, midis:

Bashkisë Belsh , e përfaqësuar nga **Z. Arif Tafani** , në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Belsh Qarku Elbasan , që më poshtë do të quhet “**Autoriteti Kontraktor**”;

dhe

ZENIT 06 shpk me NIPT K61731002D ME LICENSE N 0433/13 DATE 13.06.2016 , LESHUAR NGA MZHU ME ADMINISTRATOR Z REXHEP TARBA ME ADRESE RR MYRTEZA TOPI NDERTESA 18 ,HYRJA 7 AP 38 TIRANE

Te mëposhtëquajtur “Kontraktor”;

NENI 1 Baza ligjore

- 1.1 Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, si dhe dispozitave në fuqi për Prokurimin Publik , VKM nr 354 dt 11.05.2016 për “Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim” si dhe negocimit te bere mes paleve kontraktore me date 09.12.2016

NENI 2 Përkufizime

- 2.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Investitorit dhe Projektuesit që përmbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti i gjithë



dokumentacioni i tenderit është pjesë përbërëse dhe integrale e kontratës së shkruar e të lidhur midis palëve.

- 2.2 **“Cmim kontrate”** do të thotë çmimi që Investitori do t'i paguajë Projektuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 **“Objekt i kontratës”** do të thotë të gjitha shërbimet që Projektuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 **“Palë(t)”** do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 **“Autoriteti Kontraktor”** do të thotë enti prokurues që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimet e projektimit.
- 2.6 **“Projektues”** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë.
- 2.7 **“Shërbime”** do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Projektuesi sipas kontratës për realizimin e projektit të zbatimit.
- 2.8 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë **ditë kalendarike**.


NENI 3 Objekti i Kontratës

3.1 Objekti i kësaj kontrate është **“Hartim projektesh ”**

NENI 4 Çmimi

- 4.1 Çmimi përfshin të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni shqiptar.
- 4.2 Vlera totale e kontrates është 18.852.000 (*tetembdhjete milion e teteqind e pesedhjetë e dy mijë*) leke pa TVSH dhe 22.622.400 Leke me TVSH

- SISTEMIM ASFALTIM RRUGA TROJAS (UNAZA E QYTETIT BELSH) ME VLERE 2,892,000 LEKE PA TVSH
- SISTEMIM ASFALTIM I RRUGES GREKAN – SHELGU -GJYRALE ME VLERE 5,535,000 LEKE PA TVSH
- HARTIMI I PROJEKTTIT RIKONSTRUKSION SHKOLLE E MESME (QENDER KOMUNITARE) ME VLERE 3,942,000 LEKE PA TVSH
- RIKONSTRUKSION I RRUGES QENDER BELSH_ QAFE SHKALLE ME VLERE 1,491,000 LEKE PA TVSH
- HARTIMI I PROJEKTI KUZ LAGJE QAFE SHKALLE ME VLERE 2,841,000 LEKE PA TVSH
- HARTIMI I PROJEKTTIT TE RRUGEVE TE BRENDSHME TE LAGJES QAFE SHKALLE ME VLERE 2,151,000 LEKE PA TVSH



NENI 5 Siguracioni i përgjegjesisë profesionale

5.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

5.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

NENI 6 Mënyra e Pagesës

6.1 Pagesa për shërbimin e projektimit referuar VKM nr 354 dt 11.05.2016 për "Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" do të bëhet si më poshtë:

a) Per vitin 2016 do te paguhet shuma 1.564.000 leke me T.V.SH, diferenca e mbetur do te paguhet ne Vazhdim.

6.2 Pagesat do të kryhen në llogarinë bankare të Kontraktorit me te Shoqerise Zenit-06 sh.p.k.

6.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

6.3 Pagesa për shërbimin e parashikuar në pikën 6.1/a të kësaj kontrate do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve kalendrike nga dita kur projekt zbatimi është dorëzuar, dhe pranuar nga ana e tij.

6.4 Pagesa për shumën e parashikuar në vitin 2016 do te behet brenda 15 diteve nga marrja ne dorezim e sherbime te kryera per ket peeriudhe.

6.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

NENI 7 Afati i dorëzimit të projektit

7.1 Projekti-zbatimet sipas listes se siper cituar do të dorëzohet nga shoqëria projektuese në afat kohor prej 3 (tre) muaj kalendrike, nga data e lidhjes së Kontratës të detajuar edhe tek Dokumentat Standarte të tenderit.

7.2 Kontraktuesi brenda afatit kohor të parashikuar në pikën 7.1, duhet të paraqesë:

- Projekti zbatimin në variantin përfundimtar.
- Specifikimet teknike sipas zërave të punimeve.
- Relatimin teknik shpjegues për projektin.



- Preventivin e plotë sipas volumeve përfundimtare të punimeve.
 - Grafikon paraprak të zbatimit të punimeve sipas projektit ku të parashikohet afati i përfundimit të punimeve të zbatimit.
- 7.3 Projekti do të merret në dorëzim nga përfaqësues të Urbanistikës Bashkise Belsh , të cilët do të verifikojnë atë dhe do të lëshojnë aktin e marrjes në dorëzim të projektit.
- 7.4 Projekt-zbatimi do të hartohet në tre kopje të barabarta format A3 dhe nje CD per cdo projekt zbatimi dhe do ti dorëzohet “Autoritetit Kontraktor” Bashkisë së Belshit në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

NENI 8 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit


- 8.1 Me marrëveshje më shkrim midis palëve, afati i dorëzimit të projekt i zbatimit mund të zgjatet.
- 8.2 Në rast se palët bien dakort të zgjasin afatin e dorëzimit të projektit në ditën e fundit të dorëzimit të projekt zbatimit, Autoriteti Kontraktor nuk do të aplikojë mbi Projektuesin kamat vonesën e përcaktuar në nenin 8 “*Sanksione*”.
- 8.3 Afati i kontratës zgjatet automatikisht në rastin e Forcës Madhore. Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Projektuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë por nuk limitizohen në lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 8.4 Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Projektuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Projektuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Në se Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi menjëherë pas dërgimit të shkresës ku miratohet zgjatja e afatit për dorëzimin e projektit.

NENI 9 Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 9.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 9.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

NENI 10 Të drejtat dhe detyrimet e Projektuesit

- 10.1 Projektuesi do të hartojë Projekt- zbatimin në tre kopje të barabarta dhe do ti dorëzohet “Autoritetit Kontraktor” siç parashikohet në kushtet e kësaj kontrate.




- 10.2 Projektuesi është i detyruar t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në rradhë të parë në lidhje me cilësinë e projektit, si dhe problemeve që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit në objekt.
- 10.3 Projektuesi është i detyruar të marrë parasysh dhe të zbatojë të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga Oponenti mbi projektin.
- 10.4 Projektuesi është i detyruar të marrë në konsideratë dhe të pasqyrojë në projektin e zbatimit të objektit të gjitha zgjerimet që mund të lihen në lidhje me projektin dhe preventivin.
- 10.5 Projektuesi duhet të kryejë me mjeshtëri, kujdes dhe përkushtim të gjitha detyrimet e kësaj Kontrate.
- 10.6 Gjatë zbatimit të projektit, Projektuesi është i detyruar të marrë miratimin e Investitorit për ndryshime të projektit të cilat kanë ndikim në kosto, cilësi dhe kohë të projektit fillestar.
- 10.7 Projektuesi nuk ka të drejtë të jap projektin për përdorim apo shitje personave të tjerë të tretë pa marrë miratimin e Autoritetit Kontraktor, i cili ka të drejtën e pronësisë mbi projektin e hartuar nga Projektuesi.
- 10.8 Projektuesi ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit Kontraktor pagesën për projektin e hartuar prej tij në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

NENI 11 Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë ti kërkojë Projektuesit dorëzimin e projekt-zbatimit brenda afatit të parashikuar në pikën 7.1 të kësaj kontrate.
- 11.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë ti kërkojë Projektuesit rishikimin e projektit në rast se ai nuk i përgjet kërkesave teknike të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe nga Këshilli Teknik i Bashkisë si Oponent i projektit.
- 11.3 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i kërkojë Projektuesit të rishikojë projektin dhe të japë mendime në rast se gjatë zbatimit të objektit dalin probleme që kanë të bëjnë me projektin.
- 11.4 Porositësi është i detyruar t'i japë në kohën e duhur Projektuesit informacionin e nevojshëm që ka në dispozicion, me qëllim realizimin e projektit.
- 11.5 Autoriteti Kontraktor është i detyruar të kryej pagesën për shërbimin e projektimit në përputhje me pikën nenin 6 "Mënyra e pagesës" të kësaj kontrate.

NENI 12 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

12.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimit të Projektimit do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të



mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 13 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

13.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

NENI 14 Pronësia e projektit

14.1 Çdo gjë e dhënë ose e paguar për projektin nga Autoriteti Kontraktor, si dhe vetë projekti do të jenë pronë e Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe si e tillë do të konsiderohen kudo që do të përdoren ato.

NENI 15 Sigurimi i Kontratës

15.1 Sigurimi i Kontratës do të jetë në masën 10% të vlerës totale të kontrates. Kjo garanci ngurtësohet nga Projektuesi për llogari të Investitorit, si garanci për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë.

15.2 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Projektuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së dorëzimit dhe pranimit të projektit nga Investitori.

NENI 16 Dispozita të fundit

16.1 Palët meren vesh midis tyre vetëm me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

16.2 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet me mirëkuptim në rast të kundërt palët e mësipërme do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan.

16.3 Kjo kontratë përpilohet në pesë kopje të barabarta prej të cilave 4 kopje i mban Autoritetit Kontraktor dhe 1 kopje Projektuesi.

16.4 Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë mbas nënshkrimit të saj nga palët.

PROJEKTUESI

"ZENIT 06 SHPK."

ADMINISTRATOR

REXHEP PARBA



AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BELSH

TITULLARI I AUTORITETIT

KRYETARI

ARIF TAFANI